



DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZA E PERFORMANCËS
KORRIK-SHTATOR 2020**

TABELA E PËRMBAJTJES:

KREU I- ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS KORRIK - SHTATOR 2020

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.....	4
2. Miratimi i dy akteve të fundit në zbatim të ligjit nr. 111/2017.....	5
2.1 Miratimi i akteve të brendshme vetërregulluese të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.....	5
3. Ndihma Juridike Parësore.....	6
3.1 Hapja e qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	6
3.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	9
3.3 Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse për dhënien e ndihmës juridike parësore.....	10
4 Ndihma Juridike dytësore.....	13
5 Mbajtja, mbledhja, plotësimi dhe administrimi i të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve.....	15
5.1 Krijimi i sistemit elektronik të të dhënave (Case Management System).....	16
6 Dhënia e ndihmës juridike online.....	17
7 Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike.....	17
7.1 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	18
7.2 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore.....	20
8 Zhvillimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut.....	22
8.1 Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas”.....	23
8.2 Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.....	23
8.3 Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit.....	25
8.4 Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.....	26
8.5 Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare ndihmajuridike.gov.al në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve.....	25
8.6 Promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale.....	26
8.7 Propozim për përfshirjen e sistemit të ndihmës juridike falas si E-Shërbim në platformën E-Albania.....	26
9. Kontribute të DNJF në kuadër të raportimeve për Bashkimin Evropian.....	26
10. Angazhim i DNJF në kuadër të dokumentave strategjik.....	27
10.1 Strategjia për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti.....	27
10.2 Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (SND).....	27
10.3 Strategjia për të Miturit.....	27
10.4 Plani i veprimit të personave me aftësi të kufizuar.....	28
10.5 Plani i veprimit për Romët dhe Egjiptianët.....	28
11. Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas.....	28
12. Bashkëpunimi me donatorët.....	30

KREU II- RAPORTIMI DHE MENAXHIMI FINANCIAR.....	31
KREU III- SFIDAT PËR TË ARDHMEN.....	33

Ky raportim konsiston në ecurinë dhe zhvillimet kryesore të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas përgjatë periudhës Korrik – Shtator 2020. Raporti është hartuar në vijim të ecurive dhe zhvillimeve të pasqyruara në Raportimin Janar-Qershor 2020, dërguar Ministrin të Drejtësisë në bazë të parashikimeve të nenit 8, shkronja b) të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku përcaktohet se: “Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas i paraqet Ministrin të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike”.

Gjithashtu, bashkëlidhur këtij raportimi gjeni:

- Material përmbledhës për të dhënat statistikore mbi shërbimet e ofruara të ndihmës juridike falas gjatë periudhës Janar – Gusht 2020;
- Plani i punës Korrik-Dhjetor 2020, i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;

KREU I- ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS KORRIK-SHTATOR 2020

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas¹, në cilësinë e institucionit kryesor përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, në kuadër të përmbushjes së planit 6 mujor të punës Korrik-Dhjetor 2020², ka vijuar me kryerjen e një sërë procedurave, të cilat në mënyrë të përmbledhur parashtrohen si më poshtë vijon:

1. Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, organizimi i brendshëm i së cilës është miratuar nga Kryeministri, me Urdhër Nr. 59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë Ndhmës Juridike Falas” me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në strukturën e miratuar nga Kryeministri, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, ka në përbërje të saj drejtoritë e mëposhtme:

- *Drejtori i Përgjithshëm;*
- *Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore;*
- *Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike;*
- *Drejtoria e Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse*

Sa i përket ecures së rekrutimeve bëjmë me dije se: Me Urdhër nr. 201, datë 01.7.2020, të Ministrit të Drejtësisë është emëruar z. Ergys Qirici në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (TND).

Për tre drejtorët e drejtorive të ndihmës juridike, janë shpallur në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, vendet vakante të mbetura, referuar strukturës së DNJF dhe konkretisht:

- Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore (*Shpallja me nr. 3086*);
- Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimeve të Ndhmës Juridike (*Shpallja me nr. 3083*);
- Drejtor i Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse (*Shpallja me nr. 3082*)

Afati i dërgimit të dokumentacionit për procedurën e “*lëvizjes paralele*” dhe “*ngritjes në detyrë*” për këto pozicione përfundon më datë 30.09.2020. Në varësi të aplikimeve dhe përmbushjes së kriterëve, pritet që procedura e shpalljes së fituesve të përfundojë brenda muajit Tetor 2020, duke plotësuar kështu strukturën e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe bërjen të mundur të funksionimit me kapacitete të plota.

Ne muajin gusht me aktin nr.2942 prot., datë 16.07.2020, DAP ka njoftuar emërimin e Specialistit të Arkiv/Protokoll Sekretare nga lista e fituesve, ndër të tjera po në muajin gusht janë rinovuar

¹ Në vijim DNJF.

² Përcjellë Ministrisë së Drejtësisë me shkresën me nr. 299 prot., datë 30.07.2020.

kontatat me punonjësit e qendrës Tiranë. Ndërsa përgjatë muajit Shtator DNJF ka përfunduar procedurat e rekrutimit të punonjësve me trajnim të posaçëm për qendrën e Lushnjës (hapur më 8 shtator 2020), qendrën e Pogradecit dhe atë të Gjirokastrës (të cilat priten të inagurohen gjatë muajit tetor 2020).

2. Miratimi i dy akteve të fundit nënligjore në zbatim të ligjit nr. 111/2017

Muaji Shtator shënon një arritje të rëndësishme sa i përket miratimit të akteve të fundit nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2017, duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike. Tashmë, ligji nr.111/2017 është plotësuar dhe ndiqet nga 13 akte nënligjore të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar çdo fushë specifike të ndihmës juridike dhe kanë sjellë një seri risish e procedurash të reja.

Procedura e hartimit dhe miratimit të akteve është një procedurë e cila është ndjekur nga ana e Ministrisë së Drejtësisë sipas përcaktimeve të ligjit 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Pas një procesi të gjatë bashkëpunimi me aktorët përgjegjës në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti në muajin Shtator 2020 u bë i mundur miratimi i dy prej akteve nënligjore më të rëndësishme sa i përket mirëfunksionimit të sistemit të ndihmës juridike dytësore, konkretisht:

- **Udhëzimi i përbashkët** i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 5.8.2020 *"Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore"*;
- **Udhëzimi i Përbashkët** i Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë nr. 17 datë 05.08.2020 *"Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative"*.

Këto akte përcaktojnë rregulla të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore për qytetarët në proceset civile dhe administrative në zbatim të parimit të rotacionit, si dhe kriteret dhe tarifave të shpërblimit për këtë shërbim.

Në kuadër të hyrjes në fuqi të këtyre 2 akteve u zhvillua një **aktivitet prezantues më datë 16.09.2020, me pjesëmarrjen e Zëvendës Ministrisë së Drejtësisë**, përfaqësuesve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Dhomave Vendore të Avokatisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ekspertëve të fushës.

2.1 Miratimi i akteve të brendshme vetërregulluese të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Që nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së tyre, specialistët e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas janë angazhuar në hartimin e akteve të brendshme me karakter rregullues, konkretisht:

- **Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas**;
- **Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore** (*shtojcë e Rregullores së Brendshme të Drejtorisë*).

Kjo rregullore i është përcjellë për miratim Ministrit të Drejtësisë me shkresën me nr. 243/1 datë 20.08.2020.

Gjithashtu, DNJF ka propozuar që si pjesë e kësaj rregulloreje të përfshihet edhe kreu nr. VI *“Organizimi dhe funksionimi i komisionit vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikantëve për financim të ofj të autorizuara dhe komisionit të ankimit për shqyrtimin e ankesave të ofj të autorizuara që përfitojnë financim nga buxheti i shtetit”* si një detyrim i përcaktuar në pikën 13 të VKM nr. 110 datë 06.03.2019, *“ Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”* ku përcaktohet se: *“Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit vlerësues dhe komisionit të ankimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, që miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë”*.

Miratimi i Rregullores së Brendshme të DNJF do të jetë **një tjetër hap i rëndësishëm** në funksion të mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit të këtij institucioni duke synuar parashikime të detajuara dhe rregulla specifike për çdo proces të parashikuar nga ligji. Shtojca që i bashkëlidhet kësaj rregullore synon standardizimin e rregullave dhe procedurave dedikuar qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore të shpërndara në qarqe të ndryshme të vendit.

3. Ndihma Juridike Parësore

Bazuar në nenin 13 të ligjit 111/2017, ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;*
- b) organizatat jofitimprurëse të autorizuara;*
- c) klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Administrimi dhe promovimi i sistemit të ndihmës juridike parësore ka qenë një ndër prioritetet kyçe të DNJF. Përgjatë kësaj periudhe, DNJF ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore si dhe me organizatat ndërkombëtare partnere si UNDP; OSFA apo EURALIUS, me qëllim nxitjen dhe shtrirjen e sistemit të ndihmës juridike parësore në sa më shumë qarqe të vendit.

3.1 Hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në kompetencën e caktuar në shkronjën “gj”, të nenit 8, të ligjit nr.111/2017, DNJF administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Referuar planit të punës Korrik - Dhjetor 2020, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vijuar me procedurat në kuadër të hapjes së qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Më datë 08 shtator 2020, u zhvillua inagurimi i qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e **Lushnjës** duke shënuar kështu hapjen e qendrës së parë me buxhetin e shtetit.

Aktualisht, qytetarët përfitojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në 5 (pesë), qendra të shërbimit të ndihmës juridike, konkretisht:

- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Tiranë** (në bashkëpunim me OSFA);
- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Durrës** (në bashkëpunim me UNDP);
- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Fier** (në bashkëpunim me UNDP);
- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore në **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP);
- Qendra e shërbimit të ndihmës juridike në **Lushnje** (me buxhetin e shtetit).

Referuar planit të punës për gjashtëmujorin e dytë të vitit, është parashikuar hapja e qendrave të tjera në bashkëpunim me UNDP. Konkretisht, gjatë muajit tetor 2020 është planifikuar hapja dhe inagurimi i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Pogradecit³ dhe Gjirokastrës⁴.

**** Për sa i përket qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore në Elbasan (administruar nga ana jonë deri në muajin Korrik 2020)**

Ministria e Drejtësisë, në kuadër të projektit: “*Qendrat e Ndhmës Juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan*”, ka nënshkruar një kontratë me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë me qëllim ofrimin e shërbimeve ligjore nëpërmjet themelimit të dy qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë dhe Elbasan, (kontrata e grantit nr. 8331). Që prej datës 31.07.2020, kontrata e grantit dhe marrëdhëniet financiare të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë përfunduar. Për këtë arsye DNJF i ka propozuar OSFA-s mundësinë për rifinancimin e kësaj qendre, propozim i cili nuk është miratuar.

Në këto kushte, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, me qëllim vijimin e ofritit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Elbasanit me shkresën me nr. 330 prot., datë 17.09.2020, i propozoi Ministrin të Drejtësisë kalimin e kësaj qendre si pjesë e strukturës organizative të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe financimin e saj me buxhetin e Drejtorisë.

Hapja e qendrës në qytetin e Elbasanit ka patur si qëllim parësor ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike për t’i ardhur në ndihmë qytetarëve në këtë qark në kuadër të reformës gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë dhe pa dyshim pjesë e mbështetjes dhe të BE nëpërmjet mbështetjes buxhetore për zbatimin e saj. Ministria e Drejtësisë e cila zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike, ka si qëllim të saj parësor për vitin 2020, hapjen e qendrave në sa më shumë qytete të

³ Është planifikuar zhvillimi i inagurimit të qendrës më datë 8 Tetor 2020.

⁴ Është planifikuar zhvillimi i inagurimit të qendrës brenda muajit Tetor 2020.

Shqipërisë, qoftë ky me financim nga buxheti i shtetit ose në bashkëpunim me Fondacionin Soros dhe UNDP, ndaj edhe mbyllja e qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore në qytetin e Elbasanit do të kishte një impakt mjaft negativ në kuadër të përmbushjes së kësaj politike si dhe misionit të përbashkët: “Krijimin e një sistemi për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë.”

Nëse ky propozim merret në konsideratë, nga ana jonë do të merren të gjitha masat për ripërtëritjen e stafit të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Parësore në Elbasan përmes kryerjes së procedurave të rekturimit në mënyrë transparente dhe përmes sanksionimit të kriterëve të forta në kuadër të garantimit të cilësisë së shërbimit të ofruar nga ana e këtyre të fundit.

*****Për sa i përket qendrës së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë (administruar nga ana jonë, por në kushtet kur ambienti i kësaj qendre nuk është më i aksesueshëm)***

Që prej datës 31.07.2020, kontrata e grantit dhe marrëdhëniet financiare të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë përfunduar. Për këtë arsye DNJF i ka propozuar OSFAs mundësinë për rifinancimin e kësaj qendre, propozim i cili është miratuar duke **passjellë edhe disbursimin e grantit.**

Që prej muajit gusht 2020, zyra në katin e parë pranë Ministrisë së Drejtësisë ku ishte e vendosur kjo qendër dhe ofronte shërbimin e ndihmës juridike faslas, u prish si pjesë e projektit infrastrukturor. Për këtë arsye, stafi i qendrës është akomoduar me zyra në katin e gjashtë të ambjenteve të Ministrisë së Drejtësisë dhe për ofrimin e shërbimit dhe pritjen e qytetarëve, përdoren mënyra alternative të pritjes dhe trajtimit të rasteve nën kushtet edhe të kufizimit si rrjedhojë e covid-19. Vijon të mbetet problematikë gjetja e ambjenteve të përshtatshme për këtë qendër, në përputhje me të gjitha standardet minimale të përcaktuara në ligj të cilat mundësojnë akses për të gjithë qytetarët, sidomos duke patur në vëmendje të veçantë kategoritë vulnerabël si persona me aftësi të kufizuara, pensionistë, të mitur etj.

*****Për sa i përket qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës; Fier dhe Lezhë (administruar nga ana jonë, por në kushtet kur kontrata e grantit përfundon në Nëntor 2020)***

Qendrat e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës, Fier dhe Lezhë janë hapur nga Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe me fonde të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

Me anë të e-mailit datë 28 Shtator 2020, bëhemi me dije nga ana e UNDP se: “Kontratat e grantit për këto 3 qendra janë të vlefshme deri në fund të muajit Nëntor 2020”, dhe për këtë arsye kërkohet një vendimmarrje nga ana e Ministrisë së Drejtësisë duke parashtruar 2 opsione dhe konkretisht:

- **(Opsioni nr. 1)** Mbështetja e këtyre qendrave nga OJF e autorizuara (ku nevojitet autorizimi i ADRF nga Ministri i Drejtësisë duke qenë se nuk ka aplikuar për autorizim);
- **(Opsioni nr. 2)** Kalimi i këtyre qendrave nën administrimin e DNJF (me mbështetjen financiare të UNDP siç do procedohet me administrimin e Pogradecit dhe Gjirokastrës).

Sa i përket këtyre 2 opsioneve, DNJF mbështet opsionin nr. 2 në kushtet kur procedura e autorizimeve të organizatave jofitimprurëse të autorizuara sipas përcaktimeve të VKM nr. 55/2019, është kryer tashmë.

Kalimi i këtyre qendrave nën administrimin e DNJF (me mbështetjen financiare të UNDP) do të përbënte një hap shumë të rëndësishëm sa i përket vijimësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore në këto zona. **Vendimmarrja sa i përket ecures së këtyre qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore është shumë e rëndësishme duke marrë në konsideratë numrin e rasteve të trajtuara nga këto qendra dhe qarqet që ato mbulojnë.**

Për sa më sipër, është lehtësisht e konstatueshme se nevojitet një ri-hartëzim i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Si pasojë, referuar shkronjës “gj” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” nevojitet një vendimmarrje sa i përket:

- *Vijimit të funksionimit të qendrës së Lezhës, Fierit dhe Durrësit;*
- *Kalimit nën administrim të qendrës së shërbimit të ndihmës juridike në Elbasan;*
- *Përcaktimit të 3 qyteteve për hapjen e 3 qendrave të tjera referuar “Marrëveshjes së Dakordësisë” së nënshkruar me UNDP;*
- *Vendimmarrjes sa i përket propozimit të UNDP për kalimin nën administrim të Qendrës së Shkodrës dhe Dibrës.*

3.2 Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me qëllim ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Bazuar në nenin 3 dhe 8 të ligjit 111/2017, “Klinikë ligjore” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë, pas lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.

DNJF është duke bashkëpunuar me **6 klinikat ligjore** me të cilat janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit⁵, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të

⁵ Sic është pasqyruar edhe në raportimin e parë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, DNJF ka lidhur marrëveshje me 6 Institucione të Arsimit të Lartë (të publikuara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas” dhe konkretisht:

1. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës;
2. Kolegji Universitar “Wisdom”;
3. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;
4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;
5. Universiteti Europian i Tiranës.
6. Kolegji Universitar “Bedër”.

bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore”.

Gjithashtu, në funksion të shtrirjes së këtij bashkëpunimi edhe me Universitete të tjera, DNJF është në procedura e sipër të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me **Klinikën e ligjit pranë Kolegjit Universitar “Qiriazi”** si dhe **Klinikën e Ligjit pranë Universitetit “Mesdhetar të Tiranës”**.

DNJF në kuadër të promovimit të këtij sistemi ka planifikuar zhvillimin e një aktiviteti të përbashkët me Klinikat e Ligjit në kuadër të bashkëpunimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore i cili është planifikuar të organizohet brenda muajit Tetor 2020.

3.3 Autorizimi i Organizatave Jofitimprurëse për dhënien e ndihmës juridike parësore

Një nga risitë thelbësore të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është përcaktimi i organizatave jofitimprurëse të autorizuar si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Për herë të parë parashikohet një procedurë tërësisht e re, procedurë e cila ka për qëllim të autorizojë dhe financojë Organizata Jofitimprurëse për të ofruar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti në rrethin ku këto organizata operojnë.

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, një ndër ofruesit e ndihmës juridike parësore janë organizatat jofitimprurëse të cilat do të autorizohen nga Ministri i Drejtësisë përmes një procedure të detajuar e cila është e parashikuar **në dy akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit 111/2017**, dhe konkretisht:

- Vendimi nr. 55 datë 06.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;
- Vendimi nr. 110, datë 06.03.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”.

Organizatat jofitimprurëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare **do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore**, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Ka përfunduar i gjithë procesi i autorizimit të OJF-ve në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe më datë 10.09.2020, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimprurëse të

autorizuara me një shtritje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara janë si vijon:

1. Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara;
2. Shërbimi Ligjor Falas “TLAS”;
3. Shoqata “Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Qytetare dhe Fshatare Berat”;
4. Qendra “Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza”;
5. Shoqata “Shërbimet Shqiptare për Refugjatët dhe Migrantët”;
6. Shoqata Intelektualët e Rinj Shpresë;
7. Qendra “A.L.T.R.I.”;
8. Qendra për Nisma Ligjore Qytetare;
9. Qendra “Konsumatori Shqiptar”;
10. Shoqata “Forumi i Gruas Elbasan”;
11. Shoqata “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”;
12. Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë”.

Jo vetëm do të përfitohet shërbim ligjor falas, **por do të garantohet gjithashtu cilësi dhe profesionalizëm në ofrimin e këtij shërbimi**. OJF-të e autorizuara **përfitojnë financime** nga buxheti i shtetit si **dhe i nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes** nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë mbi “*Kriteret e vlerësimit, metodologjia dhe procedurat e mbikëqyrjes të ndihmës juridike*”.

Autorizimi i OJF-ve është **një procedurë e re, një mekanizëm i ri** që krijohet në **funksion të rrjetëzimit të institucioneve** që ofrojnë ndihmën juridike falas. **Përvoja në fushën e ndihmës juridike**, eksperiencia e gjatë e organizatave në këtë kuadër, **është një garanci e shtuar** për çdo qytetar që do të përfitojë nga shërbimet ligjore falas. Gjithashtu, **vlen të theksohet shpërndarja gjeografike e këtyre organizatave nëpër rrethe e qytete të ndryshme** (Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër), duke bërë të mundur kështu shtrirjen sa më të gjerë dhe mbulimin me shërbime ligjore falas në pothuaj të gjithë territorin e vendit.

DNJF është duke komunikuar me këta të fundit me qëllim përcjelljen e detyrimeve ligjore sa i përket administrimit të rasteve dhe bashkëpunimit të mëtejshëm në këtë kuadër.

**** Mbi problematikat e evidentuara në kuadër të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara sipas VKM nr. 110/2019.**

Pas miratimit të autorizimeve nga Ministri i Drejtësisë, DNJF **do të vijojë me shpalljen e thirrjes për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara**, procedurë e cila rregullohet me VKM nr. 110 datë 06.03.2019, “*Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti*”.

VKM nr. 55 datë 06.02.2019, përcakton me detaje procedurën e cila duhet të ndiqet dhe konkretisht mbi:

- *Hartimin dhe publikimin e planit vjetor të financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara;*

- *Hapjen e thirrjes për aplikime, kriteret e nevojshme që duhet të plotësohen nga këto OJF;*
- *Ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe komisionit të ankimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim si dhe parimet themelore që duhet të ndiqen në kuadër të vlerësimit;*
- **Lidhjen e kontratës së shërbimit dhe elementët që duhet të përmbajë ajo;**
- *Mënyrën e kryerjes së monitorimit të cilësisë së shërbimit të ofruar dhe përdorimit të fondeve të përfituara.*

DNJF, ka hasur disa paqartësi lidhur me kontratën e shërbimit që do të lidhet me këto organizata të cilat i ka parashtruar me shkresën **me nr. 278/1 prot., datë 16.09.2020**, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **me qëllim qartësimin e procedurave të financimit⁶.**

Gjithashtu, një tjetër problematikë ka të bëjë më mënyrën e kryerjes së pagesës së organizatave jofitimprurëse të autorizuara. Referuar VKM nr. 55 datë 06.02.2019, çdo organizatë jofitimprurëse nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti për organizatat jofitimprurëse. Afati kohor për përfitimin e këtyre fondeve, referuar pikës 20 të kësaj VKM është një afat 1 vjeçar.

Në këto kushte, mungesa e këtyre pikave në kontratë sjell problematikën e mos alokimit të fondit për vitin 2020, si dhe për OJF-të e autorizuara, alokimi i fondeve të kryet nga buxheti i shtetit të

⁶ Konkretisht, referuar pikës 20 të VKM nr. 55 datë 06.02.2019, DNJF lidh kontratën e shërbimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me organizatën jofitimprurëse të autorizuar të përzgjedhur, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes.

Kontrata e shërbimit lidhet për një periudhë 1 (një)-vjeçare dhe përmban:

- a) të dhëna lidhur me vlerën e financimit të përfituar;
- b) shtrirjen territoriale të shërbimit të ofruar të ndihmës juridike parësore;
- c) target-grupet e përfituesve të ndihmës juridike të synuar;
- d) mënyrën dhe mekanizmat e monitorimit të zbatimit të kontratës së shërbimit;
- e) përcaktime të qarta lidhur me qëllimin e përfitimit financiar dhe ndalimin e përdorimit të vlerës së përfituar për qëllime të tjera jashtë kontekstit të ndihmës juridike parësore;
- f) **mënyrën e kryerjes së pagesës dhe të transaksioneve financiare nëpërmjet institucioneve bankare,**
- g) në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi;
- h) shmangien e konfliktit të interesit gjatë përdorimit të masës financiare të përfituar.
- i) rastet kur kontrata e shërbimit mund të zgjidhet para përfundimit të saj;
- j) mënyrën e kthimit të vlerës financiare në rast të ndërprerjes së kontratës së shërbimit për shkaqe që lidhen me mospërmbushjen e detyrimeve nga organizata jofitimprurëse e autorizuar.

Ndërkohë nga ana tjetër, referuar Urdhrit Nr.226 datë 25.3.2019, të Ministrit të Drejtësisë *“Për miratimin e kontrave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”*, është miratuar kontrata tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017.

Në këtë kontratë tip nuk parashikohen dispozita ku mund të përfshihen të dhëna sa i përket shkronjës “a”; “b”; “c”; “d” “e”, të pikës 20 të VKM nr. 55 datë 06.02.2019.

Për këtë arsye, referuar nenit 8 shkronja “nj” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ku përcaktohet se: *“Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas harton dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë aktet nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji”* si dhe nenit 7 shkronja “e” të ligjit nr. 111/2017, ku përcaktohet se: *“Ministria e Drejtësisë miraton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrisë përgjegjëse për financat”* DNJF ka propozuar ndryshimin e Kontratës Tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore me qëllim përfshirjen e të gjithë elementëve të përcaktuar në pikën 20 të VKM nr. 55 datë 06.02.2019.

vitet 2021, sipas parashikimeve të PBA 2021-2023. Mbetemi në pritje të një përgjigjeje nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim qartësimin e procedurave.

4. Ndihma Juridike dytësore

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë⁷, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12 të ligjit nr.111/2017.

Për vitin 2020 janë lidhur kontrata me **73 avokatë** për ofrimin e ndihmës juridike dytësore sipas listës së miratuar nga DhASH, të ndarë për secilën dhomë vendore avokatie, në rang vendi.

DNJF në përmbushje të detyrave të saj funksionale të parashikuara në nenin 22 të ligjit 111/2017, po vijon me ndjekjen e seancave gjyqësore me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore me qëllim procedimin me ankimimin e tyre nëse kërkesat me objekt dhënien e ndihmës juridike dytësore janë dukshëm abuzive ose haptazi të pabazuara. Aktualisht, është përpiluar një kërkesë ankimore ndaj Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë Nr. 41 ,datë 22.07.2020, me kërkues zj. Violeta Marku, pasi Gjykata ka keqintepretuar dispozitën ligjore (neni 19) duke mos e legjitimuar zj. Marku për ngritjen e kërkesës për përfitim ndihme juridike dytësore për vajzën e saj, duke i mohuar kërkueses të drejtën kushtetuese për të përfituar avokat falas.

Gjithashtu, DNJF ka proceduar me kërkesa për ndreqje gabimesh të vendimeve gjyqësore për dhënie ndihme juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga pagimi i tarifave apo shpenzimeve gjyqësore , të cilat kanë rezultuar si më poshtë:

- *Caktim nga ana e gjykatës të avokatit që do të përfaqësojë kërkuesin në procesin gjyqësor përkatës në dispozitiv vendimi, duke përvetësuar kompetencat që ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ia atribuon Dhomave Vendore të Avokatisë;*
- *Mosbatim parashikimesh të nenit 23 të ligjit Nr.111/2017, duke mos ia komunikuar vendimin përkatës subjekteve të përcaktuara në dispozitë;*
- *Mosparashikim i të drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor dhe afatin për paraqitjen e tij, në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 22 pika 9 të ligjit Nr. 111/2017 ”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;*
- *Disponim mbi kërkesë për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, kërkesë kjo e cila nuk është bërë nga ana e kërkuesit dhe as identifikuar ne objektin e kërimit.*

Aktualisht janë kryer **14**⁸ kërkesa për ndreqje gabimesh ndaj vendimeve gjyqësore, kërkesa të cilat janë pranuar nga ana e gjykatave.

⁷ Në vijim, DhASH.

⁸ Janar-Shtator 2020

Janë ekzekutuar detyrime kontraktuale të strukturës së mëparshme **KSHNJ** me avokatët si ofruer të ndihmës juridike, konkretisht **27 dosje të përfunduara**.

Gjithashtu janë kryer **7 pagesa të detyrimeve kontraktuale** me avokatët që kanë ofruar ndihmë juridike dytësore për dosje të përfunduara nga ana e tyre.

Për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në nenin 31 të ligjit: Rastet e kthimit të përfitimeve në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, apo detyrimit të përcaktuar në nenin 32 të ligjit, Rimbursimi në rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta, DNJF për periudhën Korrik - Shtator 2020, pas verifikimit të vazhdueshëm të çështjeve gjyqësore, nuk ka konstatuar asnjë rrethanë apo indicie që mund të përfshijë rastet e përcaktuara në nenin 31 dhe 32 të ligjit.

Lidhur me zbatimin e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” kemi konstatuar disa problematika nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të cilat ia kemi bërë me dije Ministres së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor me shkresën Nr. 384 Prot., datë 28.09.2020, konkretisht:

1. Referuar nenit 49 “*Mbrojtja e detyrueshme*” të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, pika 7, parashikohet se: *Kur mbrojtja nuk mund të sigurohet sipas kësaj dispozite dhe pikës 3, të nenit 49, mbrojtja garantohet nga institucionet që administrojnë ndihmën juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi. (ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”)*. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është miratuar në kuadër të paketës ligjore të reformës në drejtësi si dhe ka të përcaktuara qartë format e ndihmës juridike⁹, kriteret për të përfituar ndihmën juridike, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve dhe të interesave të ligjshëm të tyre.

Në këtë kontekst, “*ndihma juridike dytësore*” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe **në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.**

Për të përfituar nga kjo formë e ndihmës juridike, subjektet duhet të bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta¹⁰ ose në kategorinë “subjekte me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme”¹¹, parashikuar nga ligji nr.111/2017.

⁹ Neni 5 “Ndihmë juridike parësore”; “Ndihmë juridike dytësore”; përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

¹⁰ Parashikuar nga Neni 11 i ligjit nr.111/2017.

¹¹ Parashikuar nga Neni 12 i ligjit nr.111/2017.

2. *Organi kompetent për dhënien e vendimit nuk është Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, por gjykatat dhe/ose organi procedues. Në ndryshim nga ligji i vjetër nr. 10039, datë 22.12.2018 “Për ndihmën juridike” ku parashikohej se organi i cili dilte me vendimmarrje administrative nëse kërkuesit e përfitonin ndihmën juridike detyësore ishte Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike, tashmë subjektet kërkuese e përfitojnë ndihmën juridike detyësore bazuar në kriteret e vendosura nga ligji nr.111/2017, ku Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk ka rol parësor administrativ vendimarrës, por vetëm rol ekzekutues të vendimit gjyqësor në rast pranimit të kërkesës për ndihmë juridike detyësore.*
3. *Organet kompetente vihen në lëvizje vetëm përmes kërkeses së personit të interesuar¹² dhe jo përmes institucioneve të tjera;*
4. *Ka një konfuzion lidhur me zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit nr.111/2017, pasi ky i fundit parashikon se ndihma juridike detyësore është shërbimi juridik në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal;*
5. *Organi procedues duhet të verifikojë kriteret ligjore të parashikuara nga ligji nr.111/2017 e më pas të vendosë nëse i pandehuri e përfiton ndihmën juridike falas, parashikuar edhe në Vendimin nr. 231, datë 12.11.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë i cili ka miratuar rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike detyësore në procesin penal.*

5. Mbajtja, mbledhja, plotësimi dhe administrimi i të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve

Bazuar në nenin 8 të ligjit të sipërcituar, DNJF:

- a) *administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrisë të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.*
- b) *mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimin publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj.*

Bazuar në këtë dispozitë, me udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, të Ministrisë të Drejtësisë, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave” janë përcaktuar në mënyrë të detajuar të dhënat që çdo qendër e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore duhet të raportojë.

¹² Parashikuar nga Neni 18 i ligjit nr.111/2017.

Plotësimi dhe përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti kryhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga momenti i depozitimit të informacionit pranë DNJF, sipas pikës 3 të këtij udhëzimi.

Bazuar në të dhënat e administruara, specialistët e Drejtorisë së Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Juridike Parësore *autorizuar me Urdhrin nr. 307 datë 10.08.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas* kanë vijuar me hartimin e analizave mujore statistikore. Stafi i autorizuar në këtë analizë, referuar edhe të dhënave të përcjella sipas formateve të përcaktuara në aktet nënligjore është përqendruar në përcjelljen e një **analize statistikore** sipas këtyre të dhënave e cila përmban këto të dhëna: *Mosha; Gjinia; Shtetësia; Kategoritë përfituese; Natyra e çështjes.*

5.1 Sa i përket krijimit të një sistemi elektronik të dhënash

Një ndër partnerët mbështetës të drejtorisë në kuadër të çështjeve të ndihmës juridike falas është EURALIUS, i cili ka parashikuar si aktivitet propozimin mbi krijimin e CMS (Case Management System), për ndihmën juridike. Qëllimi i këtij sistemi është administrimi i të dhënave në këto reale nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas për sa i përket rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike falas. Për sa i përket këtij projekti, stafi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ka zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të Euralius. Në mënyrë që ky projekt të implementohet nevojitet pajisja me server si dhe blerja e licencave për personat që do të kenë akses në sistem (pa këto 2 elementë sistemi nuk mund të jetë funksional). **Euralius theksoi se ky i fundit do të mbështesë vetëm krijimin (projektimin) e këtij sistemi dhe asistencën sa i përket përdorimit të tij, por nuk financon lidhur me serverin dhe licencat.**

Nga ana tjetër, DNJF ka komunikuar me përfaqësues të **Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë** mbi sistemin elektronik të të dhënave që Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë administron. Ky sistem është implementuar në Klinikat Ligjore të hapura nga ana e SOROS përmes të cilit administrohen të dhëna për të gjitha shërbimet juridike parësore të ofruara nga këto Klinika.

Nga SOROS u theksua gadishmëria dhe bashkëpunimi për ta zhvilluar më tej këtë sistem me synimin për të përfshirë të gjitha të dhënat e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas, përcaktuar në ligjin 111/2017. Përfaqësuesit e SOROS u shprehën se ky sistem është i gatshëm, funksional, lehtësisht i transferueshëm me qëllim aksesimin nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe mbi të gjitha do të financohet në vijimësi nga ana e këtij fondacioni duke mos rënduar buxhetin e Drejtorisë. Për këtë arsye, DNJF i është drejtuar shkresërisht Ministrit të Drejtësisë për vlerësimin dhe gjykimin të çështjeve të parashtruara më lartë. ***Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është shprehur dakordësia për financimin e këtij projekti nga OSFA.***

Më datë **16.09.2020**, u zhvillua një takim më konkret me përfaqësuesit të Euralius dhe OSFA në të cilin u pa e nevojshme që nga ana e OSFA të bëhej një prezantim më i detajuar i sistemit për të kuptuar më mirë sesi ky sistem funksionon dhe t'i përcillej dokumentacioni përkatës të këtij sistemi. Në vijimësi u ra dakord për zhvillimin e një takimi online, nëpërmjet platformës Zoom ku do të bëhet

një prezantim më i detajuar i sistemit të SOROS dhe mënyrës së kontrollit të cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas.

6. Dhënia e ndihmës juridike ONLINE

Funksionimi i platformës juristionline.al me qëllim dhënien e ndihmës juridike parësore online për të gjithë qytetarët: Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, është duke vijuar me ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre.

Sa i përket numrit të gjelbër **08001010**, ky i fundit ka patur probleme teknike të cilat kanë rezultuar në mosfunksionimin e plotë të tij përgjatë periudhës Gusht-Shtator 2020. Kjo problematikë ka ardhur si pasojë e mos disbursimit të fondit nga ana e OSFA. Nga ana e DNJF dhe OSFA janë duke u ndërmarrë masat me qëllim zgjidhjen e kësaj problematike në një kohë sa më të shpejtë.

7. Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes

Bazuar në nenin 8 të ligjit 111/2017, DNJF zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike duke mbikëqyrur standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

Një komponent shumë i rëndësishëm i ofrimit të ndihmës juridike falas është cilësia e këtij shërbimi. Shërbimi i ndihmës juridike falas quhet se është garantuar në mënyrë të plotë, me eficiencë dhe efektivitet vetëm atëherë kur është ofruar me cilësinë e duhur. Në këtë kuadër, është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendja e duhur kombinimit të shifrave sasiore me të dhënat e cilësisë së shërbimit. Kombinimi i të dhënave statistikore me cilësinë që ka prodhuar këto të dhëna janë ngushtësisht të lidhura me njëra-tjetrën, si pjesë e një pakete unike shërbimi dedikuar qytetarit.

Referuar Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në nenin 8 të tij, përcaktohet si një ndër detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas: Zbatimi i sistemit të vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike dhe mbikëqyrja çdo vit e standardeve të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët.

- *Për procesin e mbikëqyrjes sipas përcaktimeve të metodologjisë*

Procesi i mbikëqyrjes ka vijuar në përputhje dhe në konsultim të vazhdueshëm me metodologjinë e miratuar¹³ për këtë qëllim duke ndjekur formatet e dakorduara në këtë akt, sipas anekseve bashkëlidhur urdhrit të metodologjisë.

Sipas metodologjisë, hapat që ndiqen për monitorimin e ndihmës juridike parësore janë: *monitorimi fillestar* (ambjentet, përshtatshmëria e zyrave etj), *monitorime tre-mujore* (inspektim një ditor pranë qendrave), dhe *monitorim i vazhdueshëm* (raporte mujore të tyre dhe komunikim i vazhdueshëm), duke ndjekur indikatorët e vlerësimit të përcaktuar në metodologji. Në fund të çdo viti pune hartohet një raport përfundimtar performance për juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike pranë qendrave.

E njëjta procedurë vijon dhe me mbikëqyrjen e avokatëve të ndihmës juridike ku sipas metodologjisë kryhen monitorime fillestare dhe monitorim i vazhdueshëm për çdo avokat që ofron ndihmë juridike. Stafi i mbikëqyrjes ka akses në dokumentat elektronikë të tyre dhe në dosjet për çdo çështje. Raportet përfundimtare të performancës së avokatëve hartohen në përfundim të çështjeve gjyqësore të ngarkuara.

Raportet përfundimtare të performancës për ndihmën parësore dhe dytësore përmbajnë një vlerësim narrativ sipas indikatorëve të përcaktuar të vlerësimit, totalin e pikëve të marra sipas sistemit të pikëzimit, komente dhe rekomandime nga struktura e mbikëqyrjes së DNJF dhe komente e rekomandime nga juristi/avokati i qendrës apo avokati i ndihmës juridike dytësore sipas llojit të ndihmës juridike të ofruar.

Sipas këtyre hapave DNJF ka vijuar me procesin e mbikëqyrjes dhe kryerjen e monitorimeve për çdo ofrues të ndihmës juridike, konkretisht si vijon:

7.1 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike parësore

Ofruesit e ndihmës juridike parësore, sikurse janë përmendur gjatë këtij raporti janë:

- Qendrat e Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore;
- Organizatat jofitimprurëse të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti dhe
- Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve (me të cilat DNJF ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për këtë qëllim).

Duke qënë se ka përfunduar autorizimi i OJF-ve në për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe pritet të vijohet me hapin e dytë të financimit të tyre, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se përse i përket Klinikave të Ligjit, nuk ka përfunduar ende procesi i lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit (*do të pasohet me vijimin e një aktiviteti me të gjitha klinikat për të folur në terma konkretë për ndihmën juridike që do të ofrohet prej tyre dhe bashkëpunimin me DNJF*), procedurat e mbikëqyrjes kanë vijuar duke u ndalur si fillim tek qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, konkretisht:

¹³ Urdhër Nr. 531 Prot., datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndihmës Juridike”.

- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në qytetin e Durrësit***

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP dhe përgjatë gjithë kësaj periudhe të funksionimit të saj, DNJF ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me juristët e qendrës për dërgim të dhënash, rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punës. Në datën 15 Korrik 2020, sipas urdhrimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës, është kryer monitorimi tre – mujor pranë ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respektimin e kodit të etikës, rastet e trajtuara sipas database-eve të mbajtur nga juristët për të cilat janë mbajtur proces-verbale nga stafi. Grupi i mbikëqyrjes ka përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në MD për dijeni, vlerësim e komente.

- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ne qytetin e Fierit***

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP dhe përgjatë gjithë kësaj periudhe të funksionimit të saj, DNJF ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me juristët e qendrës për dërgim të dhënash, rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punës. Në datën 23 Korrik 2020, sipas urdhrimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës, është kryer monitorimi tre-mujor pranë ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respektimin e kodit të etikës, rastet e trajtuara sipas database-eve të mbajtur nga juristët për të cilat janë mbajtur proces-verbale nga stafi. Grupi i mbikëqyrjes ka përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në MD për dijeni, vlerësim e komente.

- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ne qytetin e Lezhës***

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP dhe përgjatë gjithë kësaj periudhe të funksionimit të saj, DNJF ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me juristët e qendrës për dërgim të dhënash, rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punës. Në datën 11 Gusht 2020, sipas urdhrimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës, është kryer monitorimi tre – mujor pranë ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respektimin e kodit të etikës, rastet e trajtuara sipas database-eve të mbajtur nga juristët për të cilat janë mbajtur proces-verbale nga stafi. Grupi i mbikëqyrjes ka përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në MD për dijeni, vlerësim e komente.

- ***Qendra e Ofrimit të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore ne qytetin e Tiranës***

Kjo qendër është hapur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OSFA dhe përgjatë gjithë kësaj periudhe të funksionimit të saj, DNJF ka qënë në kontakt të vazhdueshëm me juristët e qendrës për dërgim të dhënash, rastet e trajtuara prej tyre, problematika dhe të tjera mbi ecurinë e punës. Në datën 13 Gusht 2020, sipas urdhrimit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës, është kryer monitorimi tre - mujor pranë ambjenteve të qendrës duke ndjekur nga afër procesin e punës, respektimin e kodit të etikës, rastet e trajtuara sipas database-eve të mbajtur nga juristët për të cilat janë mbajtur proces-verbale nga stafi. Grupi i mbikëqyrjes ka përgatitur një raport mbi kryerjen e këtij monitorimi është përcjellë në MD për dijeni, vlerësim e komente.

Me përfundimin e monitorimit të të gjitha qendrave funksionale të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF ka konkluduar në disa përfundime dhe problematika të cilat kanë rezultuar nga

monitorimet në terren. Për këtë qëllim, DNJF me shkresën nr. 341 prot., datë 20.08.2020, i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe ka adresuar të gjitha problematikat e konstatuara përgjatë monitorimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Konkretisht, disa nga problematikat e konstatuara janë si vijon:

- Në rastet e trajtuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Durrës, Fier dhe Lezhë (të financuara nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim), është konstatuar se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore **ka lindur nevoja për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, dhe është proceduar nga ana e tyre me ofrimin e këtij shërbimi duke përfaqësuar çështjet në gjykatë.**
- **Mosadminstrimi i formularëve për ofrimin e ndihmës juridike parësore**, miratuar me Urdhër nr.225, datë 25.03.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.
- **Moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga metodologjia e vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike**, e miratuar me Urdhër nr. 531 datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”, nga punonjësit me trajnim të posaçëm të qendrave.
- **Nuk është plotësuar për asnjë rast të trajtuar skeda e klientit**, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur metodologjisë. (në këtë aneks përshkruhet rasti i trajtuar, një përmbledhje e problemit, koha e nevojshme për trajtimin e rastit etj).

7.2 Mbikëqyrja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Mbikëqyrja ka vijuar dhe për shërbimin e ndihmës juridike dytësore të ofruar nga avokatët e ndihmës juridike. Për avokatët të cilët kanë përfunduar çështjet e ndihmës juridike (tre prej të cilëve janë paguar nga DNJF), ka filluar procesi i mbikëqyrjes dhe kontrollit. Është ngritur grupi i punës dhe janë hartuar raportet e performancës për secilin avokat në të cilat janë paraqitur rekomandime dhe vlerësimi sipas sistemit të pikëzimit.

Gjithashtu, **ka përfunduar faza e parë e monitorimit për të gjithë avokatët e ndihmës juridike dytësore** sipas qyteteve ku ofrojnë shërbimin. DNJF ka konkluduar në disa përfundime dhe problematika të cilat kanë rezultuar nga monitorimet në terren. Për këtë qëllim, DNJF me shkresën nr. 362 Prot., datë 14.09.2020 i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë, për dijeni DHASH dhe ka adresuar të gjitha problematikat e konstatuara përgjatë monitorimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Konkretisht, disa nga **problematikat** e konstatuara lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 111/2017 janë si vijon:

1. *Mosnjohje dhe moszbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga akti nënligjor - metodologjia e vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike*, e miratuar me Urdhër nr. 531 datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”.

Një ndër aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr.111/2017 është metodologjia e vlerësimit të cilësisë së shërbimeve të ndihmës juridike, miratuar me Urdhërin e sipërcituar. Kjo metodologji iu është dërguar për njohje nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të gjithë ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike.¹⁴ Nga monitorimet e kryera konstatohen mangësi në raport me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky akt nënligjor, konkretisht:

- Nuk është mbajtur për asnjë rast të trajtuar **skeda e klientit**, sipas Aneksit 2 bashkëlidhur metodologjisë. (në këtë aneks përshkruhet rasti i trajtuar, një përmbledhje e llojit të konfliktit, zbatimi i afateve procedurale lidhur me trajtimin e rastit; strategjia e mbrojtjes etj).
- Ofruesit e ndihmës juridike dytësore **nuk janë të trajnuar në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti**. Trajnimi i profesionistëve të ndihmës juridike falas është një element thelbësor për ndihmën juridike dytësore. Avokatët e ndihmës juridike dytësore duhet të kenë trajnimet e posaçme për fushat e veprimtarisë të mbuluara prej tyre si p.sh proceset me të mitur viktima ose dëshmitarë, raste të dhunës në familje etj. Trajnimet në lidhje me fusha sensitive të tilla si dhuna në familje, mbrojtja e fëmijëve, trajtimi i personave me aftësi të kufizuara etj. kanë peshë në procesin e vlerësimit nga ana e mbikëqyrësve.

Në këtë kuadër si dhe në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional, bazuar në nenin 9 të ligjit nr. 111/2017 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, propozon të përfshihet në kurrikulat e trajnimit të vazhdueshëm – ligji nr.111/2017”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” sipas fushave specifike që ky mbulon, për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore.

2. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitim të ndihmës juridike dytësore, mbi caktimin e avokatit që do të përfaqësojë kërkuesin në procesin gjyqësor:

- Njoftim i vendimeve të Dhomave Vendore për caktim avokati që do të ofrojë shërbimet e ndihmës juridike¹⁵:

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në nenin 24 parashikon: *Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët: 2. Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme: a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit; b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.*

¹⁴ Shkresë Nr. 165 Prot., datë 24.12.2019 drejtuar DHASH dhe Dhomave Vendore të Avokatisë me lëndë “Mbi dërgimin e dokumentit “Kriteret dhe metodologjia për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”

¹⁵ Me shkresë Nr. 339 Prot., datë 19.08.2020 drejtuar DHASH me lëndë “Mbi mosushtrimin e tagrave ligjorë të kryetarit të Dhomës Vendore të Avokatisë Elbasan “

Bëjmë me dije se, edhe në rastet e caktimit të avokatit nga Dhomat Vendore, problematika vijon për shkak të *mosnjoftimit në mënyrë të rregullt dhe në kohë të Drejtorisë*¹⁶, duke sjellë kështu mungesë të të dhënave jo vetëm në funksion të plotësimit të detyrave për sa i përket mbajtjes së të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve por, më gjerë dhe në funksion të monitorimit të vazhdueshëm të avokatëve për çështjet e reja të marra në shqyrtim.

3. Mosraportimi i të dhënave nga avokatët - detyrim ligjor që rrjedh nga Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë me nr. 1, datë 08.03.2019;

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, në zbatim të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe sipas Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë me nr. 1, datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave” plotëson dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfitues të ndihmës juridike me depozitimin e informacionit pranë Drejtorisë, **sipas pikës 3 të këtij udhëzimi:**

“Çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti i dërgon periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.”

Të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti nuk raportohen nga ana e ofruesve të ndihmës juridike dytësore, detyrim ligjor ky që rrjedh nga Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë me nr. 1, datë 08.03.2019 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.

Grupi i punës, në raportet e hartuara të monitorimit për secilin ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore, ka konstatuar gjetjet e sipërpërmendura dhe ka shprehur rekomandimet përkatëse. Gjithashtu, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike falas, Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas është në komunikim të vazhdueshëm me të gjithë ofruesit e shërbimit për të garantuar dhënien e shërbimit të ndihmës juridike falas me eficiencë, cilësi dhe efektivitet.

8. Zhvillimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike, kushtet për përfitimin e saj dhe edukimin ligjor të publikut

Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj përveçse një detyrim ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të

¹⁶ Me miratimin e aktit nënligjor Udhëzimi i përbashkët MD dhe DHASH “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative” kreu II - afati për caktim avokati nga Dhoma Vendore është **8 orë**, nga marrja e vendimit të gjykatës për praninë kërkesë për NJ dytësore dhe ka detyrimin të njoftojë menjëherë DNJF për caktimin e avokatit.

qytetarëve në drejtësi, DNJF është duke i kushtuar një vemëndje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve të vizibilitetit; publikimit të postimeve/videove ndërgjegjësuese në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas si dhe lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me gjykatat dhe prokuroritë.

8.1 Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas”

Në kuadër të zbatimit të politikave në fushën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, ka proceduar me hartimin e marrëveshjeve TIP të mirëkuptimit me “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”(kopje bashkëlidhur).Kjo marrëveshje TIP ka për qëllim bashkëpunimin e aktorëve të përfshirë sipas nenit 6 të ligjit nr. 111/2017, përmes:

- *Orientimit* të subjekteve përfitues drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017 ;
- *Promovimit* të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- *Shkëmbimit të përvojës* në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- *Zhvillimit të takimeve* për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- *Kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta* me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.

Nga ana jonë fillimisht është proceduar me dërgimin e propozimit për lidhjen e kësaj marrëveshjeje, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*shkresa me nr. 358 prot., datë 09.09.2020*); Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë (*shkresa me nr. 357 prot., datë 09.09.2020*) si dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*shkresa me nr. 359 prot., datë 09.09.2020*).

Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur dakordësia për lidhjen e kësaj marrëveshjeje (*lidhur më datë 15.09.2020*), ndërsa nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë na është komunikuar fakti se për lidhjen e kësaj marrëveshjeje nevojitet paraprakisht autorizimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për këtë arsye, DNJF i është KLP dhe KLGJ me shkresën me nr. 357/1 datë 01.10.2020, me qëllim dhënien e autorizimit Gjykatave dhe Prokurorive të Republikës së Shqipërisë për lidhjen e marrëveshjeve të mirëkuptimit.

8.2 Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike

-Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Pranë ambjenteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj u zhvillua më datë 01.09.2020, një takim pune me punonjësit me trajnim të posaçëm në Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë.

Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat e sensibilizimit të qytetarëve dhe nxitjen e tyre për të marrë shërbimin ligjor falas pranë këtyre qendrave. Tashmë me qendrat funksionale në këto qytete, qendren e re të inaguruar në qytetin e Lushnjës më datë 08.09.2020, si dhe me qendrat e reja që janë planifikuar për t'u hapur përgjatë këtij viti, do të mundësohet rritja e aksesit të qytetarëve që do të përfitojnë nga ndihma juridike falas, si një ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Drejtësisë.

Gjatë këtij takimi nga ana e zj. Ministre u theksua rëndësia e shërbimit të ndihmës juridike e ofruar nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. Është shumë e rëndësishme që qendrat të bashkëpunojnë ndërmjet tyre me qëllim **ndarjen e vizionit të përbashkët** sipas rrethit ku ato operojnë. Një qasje tjetër që duhet patur parasysh në këtë kuadër është analiza nga ana e qendrave për kërkesat e trajtuara dhe grupimin e tyre sipas target grupeve që adresohen pranë këtyre zyrave. Një analizë e tillë do të shërbejë për nevojat dhe kërkesat që variojnë nga njëri qytet në tjetrin në funksion të politikës së zgjerimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas nevojave të evidentuara më sipër.

Gjithashtu, në fokus të veçantë duhet të jetë puna e vetë qendrave për të **shtuar rastet që adresohen** pranë qendrave duke vijuar me promovimin sa më shumë të jetë e mundur të shërbimit ligjor falas dhe sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Në këtë kuadër, qendrat duhet të punojnë **për të forcuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile** në drejtim të zhvillimit të fushatave sensibilizuese; takimeve të përbashkëta mbi problematikat mbi çështjet e ndihmës juridike; hartimit dhe publikimit të materialeve të vizibilitetit si dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta. Ecuria dhe zhvillimet e qendrave si dhe numri i rasteve të trajtuara do të luajnë rol kryesor në vijueshmërinë e këtyre zyrave duke krijuar qëndrueshmëri institucionale sa i përket ndihmës juridike parësore.

- Takim me organizatat jofitimprurëse të autorizuara që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti

Më datë **10.09.2020**, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12 organizatave jofitimprurëse të autorizuara me një shtrirje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Takimi u hap nga një fjalë përshëndetëse të Ministrit të Drejtësisë Zj.Etilda Gjonaj, e cila fillimisht falenderoi të pranishmit për punën e kryer ndër vite në sistemin e ndihmës juridike falas. Zj.Ministre vuri theksin në prioritetin që i jepet ndihmës juridike falas, në realizimin e së cilit kanë qenë mbështetës aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Organizatat jofitimprurëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të

sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

- Takim prezantues i dy akteve të fundit nënligjore të miratuara për Ndihmën Juridike Falas

Në kuadër të hyrjes në fuqi të akteve nënligjore mbi tarifën dhe rotacionin e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike detyësore u zhvillua një aktivitet prezantues më datë **16.09.2020**, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Drejtësisë; përfaqësuesve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore; Dhomave Vendore të Avokatisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë si dhe ekspertëve të fushës. Këto akte përcaktojnë rregulla të hollësishme për përgatitjen e listave dhe caktimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike detyësore për qytetarët në proceset civile dhe administrative në zbatim të parimit të rotacionit, si dhe kriteret dhe tarifën për këtë shërbim. Normimi i parimit të rotacionit siguron një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe më efektiv në përzgjedhjen e avokatëve që do të përmirësojë edhe shërbimin e ndihmës juridike detyësore për qytetarët në tërësi.

8.3 Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit

- Publikimi i manualit “Si të përfitojmë ndihmë juridike falas”

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja “d” dhe “e” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, *ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar*¹⁷ mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas. Manuali për ndihmën juridike u është përcjellë disa institucioneve si Bashkia Tiranë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kryeministrisë në kuadër të nxitjes dhe bashkëpunimit¹⁸.

8.4 Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/detyësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.

DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sërë takimesh me EURALIUS V¹⁹ sa i përket përmbajtjes së posterave. Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizajnimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërore në gjithë Republikën e Shqipërisë.

¹⁷ Ky manual përbëhet nga disa rubrika si vijon: Çfarë është Ndihma Ligjore Falas; Kush përfiton nga ky shërbim; Ç’lloj mbrojtjeje mund të gjej; Kujt mund t’i drejtohem për të përfituar nga ky shërbim; Cila është procedura që duhet të ndjek; Si mund të na kontaktoni. **Manualin e publikuar e gjeni në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.**

¹⁸ Shkresa me nr. 334/1 prot., datë 18.08.2020; Shkresa me nr. 334 prot., datë 18.08.2020; Shkresa me nr. 334/2 prot., datë 18.08.2020, me lëndë: “Përcjellim për dijëni manualin “Si të përfitojmë ndihmë juridike falas”.

¹⁹ Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, më datë 14 Maj 2020, organizoi një takim me z. Kestutis Vaskevicius (International Long-Term Expert Head of Administration EURALIUS V në kuadër të kërkesës për asistencë në promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas (bazuar në aktivitetin 1.4.1 të Euralius). Gjatë këtij takimi u arrit dakordësia për mundësimin e dizajnit dhe printimit të mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërore në gjithë Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kuadër më datë 29.09.2020, Drejtoria e Ndhmës ka vijuar me dërgimin e shkresave drejtuar Gjykatave; Prokurorive dhe Bashkive të Republikës së Shqipërisë për publikim të posterave në ambiente të dukshme të institucioneve.

8.5 Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare ndihmajuridike.gov.al në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve

Që prej muajit Mars 2020²⁰ faqja është finalizuar dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.

8.6 Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram

Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Kemi vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë mbajtur komunikime të vazhdueshme me qytetarët të cilët na janë drejtuar për të kërkuar informacion.

8.7 Propozim për përfshirjen e sistemit të ndihmës juridike falas si E-shërbim në platformën e-albania.

Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët, promovimi dhe informimi mbi këtë sistem është një element kyç në kuadër të rritjes së aksesit të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Si një mjet mjaft i mirë në kuadër të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas me shkresën me nr. 371 prot., datë 23.09.2020 i ka propozuar Ministrinë e Drejtësisë dhe Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA.

Kjo platformë, sidomos periudhën aktuale për shkak të pandemisë Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit “Ndhmë juridike falas” do të kishte një impakt në rritjen e nivelit të informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem.

Theksojmë se informacioni i sipërcituar është lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare web të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas si dhe në platformën juristonline por pavarësisht këtij fakti, ndërlihdja e informacionit mbi shërbimet e ndihmës juridike falas me platformën E-Albania do të

²⁰ Për sa i përket hapjes së faqes zyrtare Ueb të DNJF, në kushtet kur institucioni ynë nuk ka në organikën e tij një specialist përgjegjës për çështjet e teknologjisë së informacionit, ka kërkuar mbështetjen e EURALIUS.

ishite një hap mjaft pozitiv sa i përket ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe referimit drejt këtij sistemi. Mbetemi në pritje të dakordësisë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe AKSHI-t.

9. Kontribute të DNJF në kuadër të raportimeve për Bashkimin Evropian

DNJF si një institucion i dedikuar sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, është angazhuar që prej fillimit të funksionimit në hartimin e kontributeve të vazhdueshme në kuadër të proceseve që ndiqen me Bashkimin Evropian. Një komponent shumë i rëndësishëm kur flitet për reformën në drejtësi dhe hapat e ndjekura nga Shqipëria në kuadër të procesit të integritit evropian është aksesimi në drejtësi, garantimi i qasjes së barabartë për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër dhe duke patur në vëmendje të veçantë rëndësinë që çdo kontribut i ofruar në këtë drejtim, nga çdo institucion publik është shumë i rëndësishëm që për Shqipërinë, më në fund të çelen negociatat me BE, drejtoria është angazhuar maksimalisht në përcjellje të çdo kontributi, përditësimi mbi zhvillimet më të fundit dhe të çdo të dhëne statistikore të kërkuar.

10. Angazhim i DNJF në kuadër të dokumentave strategjike

10.1 Strategjia për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti 2020-2025

Në fillim të muajit qershor 2020, ka nisur procesi i diskutimeve mbi hartimin e një dokumenti strategjik për Drejtorinë. Në këtë proces Drejtoria është mbështetur nga ekspertë të Euralius V të cilët asistohen nga një grup përfaqësues i stafit teknik të DNJF. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar disa takime teknike pune në të cilat kanë marrë pjesë të anëtarët e grupit të punës. Gjatë këtyre takimeve është diskutuar mbi objektivat dhe prioritetet e Drejtorisë të cilat përkthyer në hartimin e draftit të parë të strategjisë dhe planit të saj të veprimit. Në mënyrë të vazhdueshme stafi i DNJF ka dhënë kontribut me komente në funksion të këtij dokumenti i cili është planifikuar të përfundojë brenda këtij viti.

10.2 Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (SND)

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është një nga institucionet që garanton aksesin në drejtësi dhe si e tillë ka një kontribut të rëndësishëm në këtë strategji dhe në zbatimin e saj përmes planit të veprimit. Gjatë kësaj periudhe DNJF është angazhuar në raportimin sa i përket masave të parashikuara në planin aktual të veprimit në zbatim të kësaj strategjie.

10.3 Strategjia e Drejtësisë për të Miturit

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2017-2020 në Republikën e Shqipërisë është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitarët e veprave penale, të miturit nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore administrative apo civile, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të së drejtave të fëmijëve.

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i ka parashikuar të miturit si kategori të veçanta përfituese. Siç paraqitet në aspektin penal, si në çështjet civile ashtu edhe në atë administrative, të miturit në konflikt me ligjin garantohen nga një numër i të drejtave procedurale dhe garancive sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017.

DNJF ka dhënë kontribut në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë si dhe po vijon t’i kushtojë një vëmendje të shtuar të miturve, si kategori të veçanta përfituese përmes aktiviteteve të ndryshme të edukimit ligjor.

10.4 Plani i Veprimit të Personave me Aftësi të Kufizuara

Në këtë draft plan veprimi janë parashikuar disa masa konkrete të cilat duhet të ndërmerren nga ana e DNJF dedikuar personave me aftësi të kufizuar në drejtim të krijimit të lehtësirave të nevojshme për rritjen e aksesit në drejtësi për këto grupe sipas nevojave të tyre specifike.

10.5 Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020

Pjesëmarrja në platformën kombëtare "Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020: Zbatimi dhe Masat Prioritare për 2020 – 2021", i cili u zhvillua online, më 29 shtator 2020, ora 13.00. Ky takim u organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ekipin e Veprimit RÇ Roma Integration 2020.

Qëllimi i Platformës Kombëtare ishte diskutimi i çështjeve kryesore për “Masat e Zbatimit dhe Prioritetit për 2019-2020 për Romët”, me synim identifikimin dhe propozimin e zgjidhjeve më efektive, të pranueshme për të gjithë aktorët, përfshirë minoritetin Rom dhe Egjiptianë, qeveritë qendrore dhe lokale, shoqëria në përgjithësi, donatorët dhe çdo palë tjetër të interesuar.

Në këtë takim, u prezantua "Raporti mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri, për vitin 2019", u diskutuan politikat kombëtare dhe prioritetet për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në pesë fushat kryesore: arsimit, punësimi, mbrojtja sociale, strehimi dhe shëndetësia. Gjetjet nga Platforma Kombëtare do të përfshihen në asistencën teknike të Integritit të Romëve që do t'i ofrohet Qeverisë në periudhën e ardhshme.

11. Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike

11.1 Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017, në të cilin parashikohet se: “*Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të*

vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm”.

Sa më sipër, nga ana e ASPA-s, me shkresën me nr. 7006/4 prot., datë 31.01.2020, u miratua **Draft Programi i trajnimeve (trajnimi fillestar i detyrueshëm), hartuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për punonjësit me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.**

Nga ana tjetër, me shkresën me nr. 386/2, datë 22.05.2020, ASPA bën me dije se referuar VKM nr. 138, datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të ASPA-s dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, konkretisht kreu III, përcaktohet se: “Për personat jashtë shërbimit civil (siç janë punonjësit me trajnim të posaçëm, marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës), paguhet tarifa prej 3000 (tre mijë) deri në 7000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi, në varësi të kohëzgjatjes së kursi”

Sa më sipër, në kushtet kur buxheti i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm e punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen qoftë atë financiare (pagesa e trajnimeve të ASPA-s), ose qoftë përmes zhvillimit të këtij trajnimi nga ana e një eksperti të kontraktuar. UNDP u shpreh e gatshme për zhvillimin e modulit të parë të trajnimit të detyrueshëm të punonjësve të qendrave përmes angazhimit të disa ekspertëve.

Më datë 24.09.2020, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas u zhvillua moduli i parë i trajnimit të detyrueshëm të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.

Në këtë trajnim, punonjësit e qendrave përfituan njohuri më të thelluara sa i përket sistemit të ndihmës juridike falas me ndryshimet që solli hyrja në fuqi e ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” duke i kushtuar një rëndësi të veçantë kuadrin ligjor specifik për kategoritë e veçanta përfituese të shërbimit të ndihmës juridike (përmendim këtu kuadrin ligjor mbi mbrojtjen e viktimave të dhunës, abuzimit seksual dhe trafikimit; të miturve në konflikt me ligjin; personave që përfitojnë ndihmë ekonomike si dhe personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim). Këto trajnime do të zhvillohen në vijimësi, në kuadër të forcimit të kapaciteteve të mëtejshme të punonjësve.

11.2 Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, i është drejtuar DhAsh me shkresë Nr. 396 Prot., datë 01.10.2020, bazuar në kompetencat që rrjedhin nga ligji Nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 9, gërma d) parashikon si detyrë të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë *përgatitjen dhe organizimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas.*

Ky parashikim ligjor gjen mbështetje dhe në ligjin nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ku në kapitullin VII “Edukimi profesional i avokatit” nenet 52 e 55,

përcaktohet se: Avokatët që do të përfshihen në listën e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, kryejnë trajnim specifik mbi fusha të së drejtës të lidhura me kategoritë përfituese të ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, duke ia atribuuar këtë kompetencë Shkollës së Avokatisë, si organ i ngritur për të realizuar këtë qëllim.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2020 me 73 avokatë në rang vendi, listuar sipas Dhomave Vendore të Avokatisë. Si rrjedhojë, nga ana jonë është propozuar që trajnimi vazhdues të zhvillohet për të 73 ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.

Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdues të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në të cilin janë parashikuar tema specifike duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, në fokus të veçantë për trajnimin vazhdues kemi parashikuar edhe nëntema të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabël, sikurse parashikohen në ligj.

Jemi duke dakordësuar me DhASH për të zhvilluar trajnimin vazhdues online brenda muajit Tetor.

11.3 Asistenca nga UNDP në kuadër të hartimit të një protokollit komunikimi

Qëllimi i kësaj asistence nga UNDP është suportimi i Drejtorisë me disa mjete praktike dhe të nevojshme në kuadër të mbajtjes së një protokollit të unifikuar komunikimi me ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike si dhe institucionet përgjegjëse për administrimin e sistemit të ndihmës juridike parësore. Nga ana e UNDP është përcjellë drafti i parë i protokollit të komunikimit, mbi të cilin Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka përcjellë komente. Më datë 02.10.2020, është planifikuar zhvillimi i një takimi për të diskutuar më konkretisht mbi nevojat e Drejtorisë në kuadër të këtij protokollit komunikimi me qëllim finalizimin e tij.

12. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare/donatorët

Aktivitetet e parashikuara në bashkëpunim me SOROS dhe UNDP dhe Euralius

UNDP

- Ndjekja e procedurave në kuadër të publikimit të **hapjes së 5 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore;**
- Mbajtja e kontakteve **me ekspertin e kontraktuar nga UNDP** me qëllim mbarëvajtjen dhe koordinimin e punës;
- Bashkëpunimi në kuadër të **publikimit të materialeve të vizibilitetit** sa i përket ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës Juridike të garantuar nga shteti.

- Bashkëpunim në kuadër të zhvillimit të trajnimeve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike;
- Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të përzgjedhjes së 5 organizatave jofitimprurëse të cilat do të mbështesin punën e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes realizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere/informuese dhe adresimit të rasteve pranë institucioneve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatit të Popullit.

SOROS

- Ndjekja e procedurave në kuadër të gjetjes së ambjenteve të përshtatshme për qendrën e shërbimit të ndihmës Juridike në Tiranë;
- Krijimi i **Case Management System** (sistem elektronik i të dhënave mbi ndihmën Juridike parësore dhe dytësore);
- Bashkëpunim në kuadër të shërbimit të ndihmës Juridike ofruar përmes **platformës online** dhe numrit të gjelbër.

EURALIUS

- Zhvillimi i një takimi pune me “Team Leader” të Euralius zj. Agnes Bernhard me qëllim vendosjen e objektivave të përbashkët dhe bashkëpunimin në terma konkretë;
- Hartimi i Strategjisë për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti (më kohëzgjatje 5 vjeçare), Kjo strategji do të jetë një mekanizëm shtesë për të bërë të mundur prioritetet/objektivat të konkretizuar me masa konkrete të cilat tejkalojnë detyrat dhe përcaktimet ligjore. **Synimi është të arrihet përtej asaj që është detyrim ligjor duke parë në një kënd më të gjerë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimieve që ky system ofron.**
- Bashkëpunimi në kuadër të publikimit të **materialeve të vizibilitetit** sa i përket ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës Juridike të garantuar nga shteti;
- Bashkëpunim sa i përket hartimit dhe publikimit të **komentarit / manual për ndihmën Juridike falas.**

KREU II- RAPORTIMI DHE MENAXHIMI FINANCIAR

Në zbatim të ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin 2020, datë.18.12.2019, në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.10296,datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara në nenin 8, pika b) *DNJF i paraqet Ministrinë të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike; dhe ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënie e ndihmës juridike*, DNJF:

- ✓ ka raportuar Ministrisë së Drejtësisë mbi realizimin e zërave të buxhetit për vitin 2020;
- ✓ ka hartuar Rregjistrin e Riskut të DNJF për vitin 2020;

- ✓ ka paraqitur Ministrisë së Drejtësisë dhe Degës së Thesarit Tiranë raportime mujore për përdorimin e buxhetit të DNJF;
- ✓ ka paraqitur Ministrisë së Drejtësisë projekt-buxhetin afatmesëm të DNJF për vitin 2019-2021;
- ✓ ka paraqitur Ministrisë së Drejtësisë raportimin cdo 3 muaj për monitorimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2020;
- ✓ ka hartuar rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2020 dhe ia ka raportuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Degës së Thesarit Tiranë;
- ✓ Pëëfitimin e grantit të ri nga OSFA
- ✓ marrjen e masave për e kontratës së grantit Nr. SG08432 për hapjen e Qendrave e Ndhmës Juridike Parësore Tiranë,

Zbatimi i buxhetit në kohë dhe në respektim të përcaktimeve/detyrimeve ligjore, përveçse një faktor orientues, është edhe një instrument stimulus për aktivitetin ekonomik nëpërmjet ekzekutimit të shpenzimeve publike. Realizimi me efektivitet i shpenzimeve buxhetore të programit, tregon një pasqyrë të saktë të shpenzimeve të realizuara.


Gjithashtu me sukses u arrit dhe përfitimi i grantit të ri i cili mundëson vijimin e funksionimit te zyres se Tiranës me buxhet jo shteteror.

Përgjateë muajit shtator u realizua hapja e qendrës së Lushnjes me buxhet të shtetit.

Të tjera transfertave për institucionet jo-fitim prurëse:

Në buxhet pjesë është dhe zëri i transfertave për institucionet OJF, ku drejtoria ka përfunduar fazen e autorizimit të OJF-ve.

Për periudhën e mbetur fondet e disponueshme rezultojnë të jenë:



Paga Shpërblime -11.519.180

Sigurime Shoqëre dhe Shëndetsore -2.043.875

Mallra dhe Shërbime – 12.682.659

Transferime Korrente Te Brendshme -8.000.000

KREU III- SFIDAT PËR TË ARDHMEN

SFIDAT me qëllim zhvillimin dhe promovimin e sistemit të ndihmës juridike sfidat e rëndësishme për periudhat janë:

- ✚ Shtrirja e shërbimit të ndihmës juridike parësore në të gjithë territorin e vendit;
- ✚ Promovimi sa më shumë i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke synuar ndërgjegjësimin dhe si rrjedhojë rritjen e numrit të kërkesve për ndihmë juridike;
- ✚ Bashkëpunimi më proaktiv nga institucionet që përfshihen në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti si dhe nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike (*përmendim këtu Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara*);
- ✚ Rritja e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshëm nga DNJF;

SHTOJCË 1

NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI

TË DHËNA STATISTIKORE

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE

<i>Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore (Janar-Shtator 2020)</i>	
Tiranë	422 <i>Shënim: Numri i rasteve të trajtuara është i lidhur me situatën aktuale të pandemisë në kushtet kur punonjësit pranë kësaj qendre janë detyruar të vetëkarantínohen për shkak të rezultimit pozitiv me COVID-19 të njërit prej punonjësve.</i>
Durrës	211
Fier	126
Lezhë	215
Totali i rasteve të trajtuara: 974 raste	

<i>Organizatat jofitimprurëse të autorizuar (10 Shtator 2020-30 Shtator 2020, periudha që nga momenti i autorizimit)</i>	
“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”	27 raste
“Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	20 raste
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	0 raste²¹
“Intelektualët e rinj shpresë”	5 raste
“Qendra për mbrotjtjen e të drejtave të fëmijeve në Shëqipëri (CRCA)”	6 raste
“Forumi i Gruas Elbasan”	21 raste
“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	117 raste
“Të ndryshëm dhe të barabartë”	17 raste
“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	5 raste
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	40 raste

²¹ Që nga momenti i autorizimit, QSHPLI ka realizuar një mbledhje bordi duke filluar veprimet përgatitore për fillimin e ofrimit të shërbimit të ndihmes juridike si psh. përgatitje e materjaleve informuese për shërbimin duke afishuar edhe numrat e kontaktit. Po ashtu, takime me kancelarët pranë Gjykatave dhe Prokurorive kryesore janë në fazë organizimi. Ndaj sa i përket muajit të kaluar nuk ka patur ofrim shërbimi direkt për qytetarët.

“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	*Nuk janë përcjellë të dhëna pavarësisht njoftimit të përsëritur
“Qendra Konsumatori Shqiptar”	25 raste ²²
<i>Totali i rasteve të trajtuara: 283 raste</i>	

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

<i>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndihmën Juridike (Januar – Shtator 2020)</i>				
<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike</i>	<i>Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pushim çështjeje</i>
64	15	11	14	1
<i>Totali i Vendimeve Gjyqësore = 105</i>				

NDIHMA JURIDIKE ONLINE

Platforma juristionline.al

<i>Të dhëna statistikore (Mars – Shtator 2020)</i>
<i>Ndihmë juridike parësore / këshillime / Informacion ligjor</i>
Totali i rasteve të trajtuara = 1021

²² Shënim: Qendra ka një veçanti në trajtimin e rasteve, sepse synon mbrojtje të interesave kolektive, për pasojë nuk mund të evidentohen të gjithë individët, sepse ëçëfitimi është më i madh. Përmendim këtu: “Ankesë drejtuar UKT - Tiranë - për të gjithë banorët e Tiranës - ende në shqyrtim”.

PLAN PUNE

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Korrik – Dhjetor 2020

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas²³, në cilësinë e institucionit përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike ndjek të gjitha proceset e punës dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe me partnerët ndërkombëtarë me qëllim garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët përmes ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas. Për këtë qëllim, DNJF ka hartuar plane pune në të cilët janë përcaktuar hap pas hapi të gjitha objektivat që synohen të arrihen gjatë një periudhe të caktuar si dhe aktivitetet e menduara për të zbatuar këto objektiva. Në vijim të planit të punës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2020 (plani i punës janar – qershor 2020), është hartuar plani edhe për gjashtëmuorin e dytë (plani i punës korrik – dhjetor 2020), në të cilin u identifikuan të gjitha proceset më të rëndësishme për këtë periudhë.

Në këtë plan pune janë parashikuar **10 objektiva** të cilat synojnë dhe kanë karakter politikbërës, rregullator, menaxhues dhe legjislativ.

Konkretisht, **objektivat janë strukturuar** si vijon:

1. Forcimi i sistemit të ndihmës juridike parësore
2. Forcimi i sistemit të ndihmës juridike dytësore
3. Vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes
4. Bashkëpunimi me donatorë dhe institucionet e përfshira në sistemin e ndihmës juridike falas
5. Rritje e angazhimit të DNJF në kuadër të dokumentave strategjike
6. Rritje e angazhimit të DNJF në kuadër të procesit të integritetit evropian
7. Promovimi i sistemit të ndihmës juridike
8. Forcimi i kapaciteteve të stafit të DNJF / ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike
9. Raportime mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti
10. Menaxhimi dhe planifikimi financiar i sistemit të ndihmës juridike

PRIORITETI: Reforma në drejtësi

Mirëfunksionimi i sistemit të ndihmës juridike falas

RRITJA DHE FORCIMI I AKSESIT NË DREJTËSI

OBJEKTIVI 1: FORCIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuar a	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës (Personat përgjegjës)	Afate / komente
1.1	Ofrimi i ndihmës juridike parësore	Hapja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Qytetin e Lushnjës	Hapja e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës	Ministria e Drejtësisë	Brenda muajit Korrik (Përfunduar)²⁴

²³ Në vijim, DNJF.

²⁴ Pritet të zhvillohet aktiviteti i inagurimit të kësaj qendre.

	<p><i>nga Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore</i></p>	<p>Hapja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Qytetin e Gjirokastrës</p> <p>Hapja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Qytetin e Pogradecit</p> <p>Hapja e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Qytetin e Kukësit</p> <p>Hapja e 2 qendrave të tjera brenda vitit 2020 në bashkëpunim me UNDP (<i>identifikimi i qyteteve respektive në varësi të disponibilitetit dhe bashkëpunimit nga institucionet vendore</i>)²⁵</p> <p><i>Takim pune me të gjitha qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (vendosja e prioriteteve dhe objektivave të përbashkët në funksion të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore)</i></p>	<p>Juridike Parësore në bashkëpunim me UNDP (5 qendra të reja brenda vitit 2020)</p>	<p>DNJF</p> <p>UNDP</p> <p>ADISA</p> <p>Bashkitë Respektive</p>	<p>Korrik –Shtator</p> <p><i>(Zyra është përfunduar janë në proces të pajisjes me kompjutera)</i></p> <p>Shtator</p> <p>Tetor – Dhjetor</p> <p>Brenda vitit</p> <p><i>(identifikimi do të kryhet në bashkëpunim me UNDP dhe sipas një vlerësimi paraprak për shtrirjen e këtij shërbimi sa më gjerë)</i></p> <p>Shtator</p>
1.2	<p><i>Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuar</i></p>	<p>Përfundimi i procesit të shqyrtimit të aplikimeve nga Komisioni i Vlerësimit në DNJF dhe dërgimi i propozimeve me relacionet shoqëruese</p> <p>Përfundimi i procedurave të autorizimit dhe financimit sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore respektive</p> <p><i>Takim pune me OJF-të e autorizuar për të ofruar ndihmë juridike parësore (vendosja e prioriteteve dhe objektivave të përbashkët në funksion të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore)</i></p>	<p>Autorizimi i OJF-ve për dhënien e ndihmës juridike parësore</p>	<p>Komisioni i Vlerësimit në DNJF</p> <p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>DNJF</p>	<p>Korrik</p> <p><i>(Përfunduar)</i></p> <p>Shtator</p> <p>Shtator</p>

²⁵ Berati & Vlora për t'u vlerësuar nga MD, DNJF dhe UNDP, si qytete të mundshme ku mund të hapen qendrat e reja.

1.3	<i>Ofrimi i ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit</i>	<i>Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> me të gjitha Klinikat e Ligjit që kanë shprehur interes në ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti	Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike parësore	Ilberjan Durmishi	Shtator-Tetor
		<i>Takim pune</i> në përfundim të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjitha Klinikat e Ligjit (<i>vendosja e prioriteteve dhe objektivave të përbashkët në funksion të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore</i>)		DNJF	Pas përfundimit të lidhjes së marrëveshjeve
1.4	Administri mi i qendrave të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore	Caktimi i një koordinatori për qendrat ²⁶ që Drejtoria e Ndihmës Juridike administron me qëllim: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillimin e takimeve orientuese; - administrimin e të dhënave dhe përcjelljen e çdo problematike të punonjësve të qendrave; - zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta etj.. 	Koordinimi dhe mbajtja e kontakteve me çdo qendër për t'u informuar mbi ecurinë e veprimtarisë	Koordinatori i caktuar Klejda Poci Suela Qevani	Proces në vijim <i>Të dhëna mbi baza javore & mujore</i>
1.5	Administri mi i OJF-ve të autorizuar	Caktimi i një koordinatori për OJF- të e autorizuar me qëllim: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillimin e takimeve orientuese; - administrimin e të dhënave dhe përcjelljen e çdo problematike të punonjësve të qendrave; - zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta etj.. 	Koordinimi dhe mbajtja e kontakteve me çdo OJF për t'u informuar mbi ecurinë e veprimtarisë	Koordinatori i caktuar Patricia Pogace	Proces në vijim <i>Të dhëna mbi baza javore & mujore</i>
1.6	Administri mi i Klinikave të Ligjit	Caktimi i një koordinatori për Klinikat e Ligjit me qëllim: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillimin e takimeve orientuese; - administrimin e të dhënave dhe përcjelljen e çdo problematike të punonjësve të qendrave; - zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta etj.. 	Koordinimi dhe mbajtja e kontakteve me çdo Klinikë Ligji për t'u informuar mbi ecurinë e veprimtarisë.	Koordinatori i caktuar Ilberjan Durmishi	Proces në vijim <i>Të dhëna mbi baza javore & mujore</i>
1.7	Administri mi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës	Koordinatorët përgjegjës për çdo Klinikë; Qendër; OJF- të autorizuar, kontaktojnë me këto të fundit për përcjelljen e të dhënave sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi.	Administrimi i të dhënave të sakta/reale nga qendrat/ OJF-të/ Klinikat e Ligjit/ platformës	Të gjithë koordinatorët	Proces në vijim <i>Të dhëna mbi baza javore & mujore</i>

²⁶ Aktualisht funksionale qendrat pranë qyteteve të Tiranës, Elbasanit, Durrësit, Fierit dhe Lezhës.

<i>juridike parësore</i>	Pas administrimit të të dhënave, çdo kordinator harton mbi baza javore dhe mujore një dokument me të dhëna statistikore. Analizat statistikore bashkohen duke dalë në një produkt të vetëm.	juristonline/nu mrit të gjëlber Hartimi i analizave të detajuara statistikore ²⁷		
--------------------------	---	--	--	--

OBJEKTIVI 2: FORCIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

Nr.	Masat / proceset e planifikuar a	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës <i>(Personat përgjegjës)</i>	Afate / komente
2.1	<i>Bashkëpunimi me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike</i>	Nënshkrimi i kontratave për ofrim të ndihmës juridike dytësore (<i>me avokatët që ende nuk janë nënshkruar</i>)	Forcimi i sistemit të ndihmës juridike dytësore	Ornela Ferhati Ersian Gripshi Kristi Petrela Etleva Zeqiraj	Proces në vijim
2.2	<i>Administrimi i plotë i të dhënave mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore</i>	Caktimi i dy kordinatorëve për avokatët e ndihmës juridike dytësore me qëllim: - Zhvillimin e takimeve orientuese; - Administrimin e të dhënave dhe përcjelljen e çdo problematike, konkretisht: - <i>Plotësimi i databasave sipas përcaktimeve të ligjit dhe</i> - <i>Mbajtja e të dhënave e statistikave për të gjitha vendimet gjyqësore si dhe për çdo kërkesë që bëhet nga DNJF në funksion të sistemit të ndihmës juridike dytësore.</i> - Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta etj..	Koordinimi dhe mbajtja e të dhënave për t'u informuar mbi ecurinë e veprimtarisë	Koordinatorët e caktuar Kristi Petrela Ornela Ferhati	Proces në vijim <i>Të dhëna mbi baza javore & mujore</i>

²⁷ Gjetjet statistikore janë thelbësore në kuadër të propozimit të politikave të mëtejshme me qëllim nxitjen dhe mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike parësore.

2.3	<p><i>Ndjekja e vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimi me gjykatat për komunikimin e vendimeve gjyqësore dhe ndjekja e ecurisë dhe zbatimit të tyre²⁸; - Bashkëpunimi me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe me Dhomat Vendore në kuadër të caktimit të avokatit që do të përfaqësojë kërkuesin në procesin gjyqësor; - Ankimimi i vendimeve gjyqësore me objekt përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga shpenzimet / tarifatat gjyqësore, nëse provohet se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar; - Kërkesë për ndreqje gabimesh në vendimet gjyqësore për përfitim ndihme juridike dytësore; <p>✚ Hartimi i një materiali përmbledhës për ndihmën juridike dytësore, në të cilin të përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Të gjitha vendimet gjyqësore</i> me këtë objekt; - <i>Statistika të prodhuara nga këto vendime</i>²⁹ <i>(sa është nr. Total i vendimeve, sa janë refuzime sa janë pranime për ndihmë juridike, sa janë ankimuar prej tyre nga ana e DNJF, për sa prej tyre është bërë kërkesë për ndreqje gabimesh, sa kërkesa të tjera ka me objekt bashkëpunim në funksion të ndihmës dytësore, etj);</i> - <i>konstatime e problematika dhe përpjekjet e bëra nga DNJF</i> për të adresuar drejt problematikën dhe për të gjetur mundësi e rrugë të reja bashkëpunimi. 	<p>Zbatimi me efikasitet i vendimeve gjyqësore, në drejtim të përfitimit të ndihmës juridike dytësore</p>	<p>Xhulia Mulla Ornela Ferhati Ersian Gripshi Kristi Petrela Etleva Zeqiraj</p>	<p>Proces në vijim</p> <p><i>Të dhëna mbi baza javore & mujore</i></p>
-----	--	--	---	--	---

²⁸ Të mbahen të dhëna për çdo vendim që komunikohet në DNJF, për çdo kërkesë që kjo e fundit i drejton gjykatave, Dhomës së Avokatisë apo çdo institucioni tjetër të përfshirë.

²⁹ Shih masën nr.2.2 (Objektivi nr.2).

OBJEKTIVI 3: VLERËSIMI I CILËSISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE DHE PROCEDURAT E MBIKËQYRJES

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës <i>(Personat përgjegjës)</i>	Afate / komente
3.1	<i>Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore</i>	<p>Kryerja e monitorimit fillestar për çdo qendër të re të shërbimit të ndihmës juridike parësore</p> <p>Kryerja e monitorimeve tremujore për qendrat e ndihmës juridike parësore</p> <p>Monitorimi dhe kontaktimi i vazhdueshëm me qendrat; dërgimi i raporteve mujore narrative mbi ecurinë e punës³¹</p> <p>Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës</p>	Shërbimet e ndihmës juridike parësore ofrohen me cilësi dhe efektivitet	Xhulia Mulla Ornela Ferhati Ersian Gripshi Kristi Petrela Etleva Zeqiraj	Proces në vijim ³⁰
3.2	<i>Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Avokatët e ndihmës juridike dytësore</i>	<p>Kryerja e monitorimit fillestar për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore</p> <p>Kryerja e monitorimit të vazhdueshëm për çdo avokat të ndihmës juridike dytësore</p> <p>Hartimi i raporteve të monitorimit / Vlerësimi i performancës</p>	Shërbimet e ndihmës juridike dytësore ofrohen me cilësi dhe efektivitet	Xhulia Mulla Ornela Ferhati Ersian Gripshi Kristi Petrela Etleva Zeqiraj	Proces në vijim
3.3	<i>Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar përmes platformës juristionline .al</i>	<p>Mbikëqyrja e shërbimit online të ndihmës juridike falas të ofruar përmes platformës juristionline.al</p> <p>Hartimi i raporteve të mbikëqyrjes dhe përcjellja e rekomandimeve përkatëse</p>	Shërbimet e ndihmës juridike ofrohen me cilësi dhe efektivitet	Personat përgjegjës Xhulia Mulla Patricia Pogace	<i>Raportet hartohen mbi baza javore dhe mujore</i>

OBJEKTIVI 4: BASHKËPUNIMI ME DONATORË DHE INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr.	Masat / proceset e	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
-----	--------------------	----------------------------------	---------------------------------	-----------------------------	-----------------

³⁰ Afatet e monitorimeve janë përcaktuar në **kalendarin e monitorimeve** të hartuar për këtë qëllim. Për monitorimet nuk mund të vendosen data fikse në planin e punës pasi mund të ndryshohen në varësi të kushteve dhe për këtë arsye është hartuar një kalendar monitorimesh i cili do të vijojë të përditësohet me data konkrete për çdo muaj respektiv.

³¹ Sipas **formatit narrativ të hartuar** mbi bazën e të cilit qendrat kanë vijuar të dërgojnë të dhënat mbi ecurinë e punës dhe veprimtarinë mujore.

	planifikuar a		Qëllimi	(Personat përgjegjës)	
4.1	Ndjekja e proceseve të punës me EURALIUS V në kuadër të projekteve të përbashkëta	<p>Grup pune për hartimin e Strategjisë 5-vjeçare për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti dhe Planit të saj të Veprimit³² (staf nga DNJF dhe ekspertë të kontraktuar nga Euralius);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndjekje e takimeve me ekspertët e Euralius; - Dhënie kontributi në funksion të hartimit të drafteve finale³³ të strategjisë dhe planit të veprimit; - Dhënie informacioni mbi proceset teknike të drejtorisë me qëllim pasqyrimin strategjik të tyre në këtë dokument politikash; - Ndjekje e procesit të kostimit të strategjisë duke parashikuar vlera të veçanta për çdo aktivitetet që do të jetë pjesë e planit të veprimit në zbatim të kësaj strategjie. <p>Pas miratimit të Strategjisë dhe Planit të saj të veprimit parashikohen pikat si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategjia dhe Plani i Veprimit do të ndiqen nga grupi i punës në vijimësi, hap pas hapi me qëllim sigurimin e implementimit të çdo mase e aktiviteti të parashikuar në të; - Gjithashtu, do të ndiqet çdo nevojë që do të lindë në funksion të rishikimit të këtij dokumenti strategjik për ta përshtatur me zhvillimet e reja dhe dinamikat e DNJF, ofruesve të ndihmës juridike, aktorëve të tjerë të përfshirë etj. 	<p>Forcimi i bashkëpunimit</p> <p>Dhënia e kontributit sa i përket proceseve të përbashkëta me DNJF</p>	<p>Patricia Pogace</p> <p>Xhulia Mulla</p> <p>Daniela Ndrejaj</p>	Proces në vijim

³² **Krijimi i Case Management System** është parashikuar nga EURALIUS në draftin e Strategjisë për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti. Duke qënë se edhe SOROS është angazhuar për një sistem elektronik të ngjashëm, **DNJF do të zhvillojë një takim të përbashkët me pjesëmarrje të partnerëve të sipërpërmendur me qëllim koordinimin e proceseve të tyre për të bërë të mundur një sistem elektronik funksional e operativ për DNJF (të dhëna në kohë reale për ndihmën juridike parësore dhe dytësore), në varësi të çfarë do diskutohet dhe çfarë ofron secili sistem.**

³³ **Është hartuar drafti i parë i Strategjisë 5-vjeçare për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (për vlerësim dhe komenteve finale nga grupi i punës), dhe do vijohet me planin konkret të veprimit (aktualisht aktivitetet janë të papubxhetuara pasi nuk ka nisur procesi kostimit).**

		Ndjekja e procedurave në kuadër të publikimit të manualit të ligjit për ndihmën juridike dhe posterave promovues mbi shërbimin e ndihmës juridike dytësore nëpër gjykata		Patricia Pogace Xhulia Mulla	
		Ndjekje e proceseve të tjera që Euralius zhvillon në mbështetje të DNJF			
4.2	<i>Ndjekja e proceseve të punës me UNDP në kuadër të projekteve të përbashkëta</i>	Ndjekja e procedurave në kuadër të publikimit të hapjes së 5 qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore		Pika kontakti Patricia Pogace Xhulia Mulla	Proces në vijim
		Mbajtja e kontakteve me ekspertin e kontraktuar nga UNDP me qëllim mbarëvajtjen dhe koordinimin e punës		Suela Qevani Klejda Poci	
4.3	<i>Ndjekja e proceseve të punës me SOROS në kuadër të projekteve të përbashkëta</i>	Ndjekja e procedurave në kuadër të krijimit të një <i>Case Management System</i> ³⁴		MD (Mbështetje nga IT e Ministrisë) Suela Qevani Klejda Poci	Proces në vijim
		Ndjekja e procedurave në kuadër të gjetjes së ambienteve për qendrën e shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë			
		Ndjekje e proceseve të tjera që SOROS zhvillon në mbështetje të DNJF			
OBJEKTIVI 5: RITJE E ANGAZHIMIT TË DNJF NË KUADËR TË DOKUMENTAVE STRATEGJIKE					
Nr.	Masat / proceset e planifikuar a	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës (Personat përgjegjës)	Afate / komente

³⁴ **Krijimi i Case Management System** është parashikuar dhe nga EURALIUS në draftin e Strategjisë për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti. Duke qenë se edhe Euralius është angazhuar për një sistem elektronik të ngjashëm, DNJF do të zhvillojë një takim të përbashkët me pjesëmarrje të partnerëve të sipërpërmendur **me qëllim koordinimin e proceseve të tyre për të bërë të mundur një sistem elektronik funksional e operativ për DNJF (të dhëna në kohë reale për ndihmën juridike parësore dhe dytësore), në varësi të çfarë do diskutohet dhe çfarë ofron secili sistem.**

5.1	Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP) ³⁵	Ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe plan veprimi me qëllim përmbushjen e objektivave të parashikuar për ndihmën juridike	Garanci shtesë në drejtim të forcimit të aksesit në drejtësi përmes shërbimeve të ndihmës juridike falas Promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas Forcimi i bashkëpunimit	Xhulia Mulla Daniela Ndrejaj	Proces në vijim
5.2	Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (SND)	Ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe plan veprimi me qëllim përmbushjen e objektivave të parashikuar për ndihmën juridike <i>Kontribut i vazhdueshëm në kuadër të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit të SND (mbi baza tre mujore, dhe vjetore)</i>	Garanci shtesë në drejtim të forcimit të aksesit në drejtësi përmes shërbimeve të ndihmës juridike falas Promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas Forcimi i bashkëpunimit	Xhulia Mulla Daniela Ndrejaj	Proces në vijim
5.3	Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK)	<i>Kontribut i vazhdueshëm në kuadër të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit të SNKK</i>	Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën e përbashkët kundër korrupsionit	Pikë kontakti antikorrupsion Xhulia Mulla	Proces në vijim

³⁵ Gjatë këtyre muajve është hartuar Plani i Veprimit në zbatim të SELP (i cili pritet të miratohet). **Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023, është një instrument i rëndësishëm me fokus parashikimin e masave konkrete mbi informimin ligjor dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.** Është pikërisht Plani i Veprimit në zbatim të kësaj strategjie, dokumenti në të cilin përmbledhen të gjitha aktivitetet dhe masat në përmbushje të objektivave strategjike. Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas është një nga institucionet e përfshira në këtë plan masash.

5.4	Angazhim i DNJF në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit (SDM)	<p><i>Ndjekja e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në strategji dhe plan veprimi me qëllim përmbushjen e objektivave të parashikuar për ndihmën juridike</i></p> <p><i>Kontribut i vazhdueshëm në kuadër të monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit të SDM (mbi baza tre mujore, dhe vjetore)</i></p>	<p>Garanci shtesë në drejtim të forcimit të aksesit në drejtësi përmes shërbimeve të ndihmës juridike falas</p> <p>Promovimi i sistemit të ndihmës juridike falas</p> <p>Forcimi i bashkëpunimit</p>	<p>Xhulia Mulla</p> <p>Daniela Ndrejaj</p>	Proces ne vijim
-----	---	--	--	--	-----------------

OBJEKTIVI 6: RRRITJE E ANGAZHIMIT TË DNJF NË KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës <i>(Personat përgjegjës)</i>	Afate / komente
6.1	<i>Raportime në kuadër të procesit të Integrimit Evropian për progresin e arritur mbi forcimin e aksesit në drejtësi dhe shërbimet ligjore falas</i>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Kontributit i Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë (komponenti i ndihmës juridike);</i> - <i>Kontribut në kuadër të Nën – Komitetit, “Drejtësi, Liri dhe Siguri”.</i> - <i>Kontribute të tjera të kërkuara në kuadër të progresit të bërë (të dhëna statistikore)</i> - <i>Kontribut mbi procesin e përafrimit të legjislacionit me Acquis e BE.</i> 	Përmirësim i vazhdueshëm dhe progres i arritur në funksion të garantimit të aksesit të barabartë në drejtësi për kategoritë në nevojë duke patur në fokus rekomandimet e vazhdueshme nga BE	Xhulia Mulla	Proces ne vijim

OBJEKTIVI 7: PROMOVIMI I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës <i>(Personat përgjegjës)</i>	Afate / komente
-----	---------------------------------	----------------------------------	---------------------------------	---	-----------------

7.1	Përgatitja dhe ndjekja e publikimeve të DNJF në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Facebook, instagram	Ndjekje e procedurave të nevojshme me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve.	Rritja e ndërgjegjëimit të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike falas	Patricia Pogace Xhulia Mulla Klejda Poci	Proces në vijim
7.2	Zhvillimi i takimeve promovuese /sensibilizuese (Online në kushtet e Pandemisë); Video e spote ndërgjegjëse	Forcimi i urave të bashkëpunimit në kuadër të promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	Rritja e ndërgjegjëimit të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike falas Forcimi i bashkëpunimit	Gjithë stafi	Shtator - dhjetor

OBJEKTIVI 8: FORCIMI I KAPACITETEVE TË STAFIT TË DNJF / OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE

Nr.	Masat / proceset e planifikuara	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës (Personat përgjegjës)	Afate / komente
8.1	Bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike dhe ASPA	Ndjekja e procedurave të rekrutimit të stafit të DNJF / punonjësve me trajnim të posaçëm; Ndjekja dhe sigurimi i zbatimit të legjislacionit mbi shërbimin civil, legjislacioni i punës dhe legjislacioni mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.	Forcimi i kapaciteteve	Ani Grizhja	Proces në vijim
8.2	Mbajtja dhe azhurnimi i Data-Base në bashkëpunim me DAP për		Forcimi i kapaciteteve	Ani Grizhja	Proces në vijim

	<i>punonjësit e DNJF</i>				
8.3	<i>Trajnimi i punonjësve me trajnim të posaçëm në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe trajnimi i studentëve të Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë</i>	Ndjekje e procedurave të nevojshme për të bërë të mundur realizimin e këtyre trajnimeve	Rritje dhe forcimi i kapaciteteve Rritje e performancës, efektivitetit dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike	DAP ASPA Donatorë Ani Grizhja Ilberjan Durmishi	Proces në vijim Shtator - dhjetor ³⁶
8.4	<i>Trajnimi i avokatëve të ndihmës juridike dytësore referuar ekspertizës për secilën nga kategoritë e veçanta të parashikuara nga ligji</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Ndjekje e procedurave të bashkëpunimit me DhASH për të bërë të mundur zhvillimin e këtyre trajnimeve; - Propozim për kurrikul të veçantë trajnimi sipas çdo specifike të parashikuara në ligj. 	Rritje dhe forcimi i kapaciteteve Rritje e performancës, efektivitetit dhe cilësisë në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike	DhASH DNJF Ani Grizhja Etleva Zeqiraj	Proces në vijim
8.5	<i>Trajnimi i stafit të DNJF sipas specifikave të secilës drejtori respektive</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i një materiali me nevojat e stafit të DNJF - Koordinimi me donatorë të ndryshëm për mbështetje sa i përket trajnimeve që ofrojnë 	Rritje dhe forcimi i kapaciteteve	DNJF Ani Grizhja	Proces në vijim

OBJEKTIVI 9: RAPORTIME MBI SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

Nr.	Masat / proceset e	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/	Institucioni/Dr. Përgjegjës	Afate / komente
------------	---------------------------	---	-----------------------------	------------------------------------	------------------------

³⁶ Është konstatuar se ofruesit e ndihmës juridike parësore pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë nevojë për trajnime specifike sipas parashikimeve të reja që sjell ligji.

	planifikuar a		Qëllimi	(Personat përgjegjës)	
9.1	<i>Përgatitja e raportimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti³⁷</i>	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i raportimeve 3 mujore drejtuar Ministrit të Drejtësisë; - Hartimi i raportimeve 6 mujore drejtuar Ministrit të Drejtësisë; - Hartimi i raportimeve të tjera drejtuar Ministrit të Drejtësisë në varësi të kërkesave 	<p>Zbatimi i detyrimeve ligjore</p> <p>Mirëfeksionim i i sistemit të ndihmës juridike falas</p> <p>Eficiencë dhe efektivitet për të garantuar akses të barabartë në drejtësi përmes shërbimeve juridike falas</p>	Patricia Pogace Xhulia Mulla	Proces në vijim <i>Raporte mbi baza tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore</i>
9.2	<i>Trajtimi i shkresave nga institucione të ndryshme (kombëtare/ndërkombëtare) në kuadër të raportimit mbi ecurinë dhe progresin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti</i>	Dhënia e informacionit mbi ecurinë dhe zhvillimet e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti	<p>Mirëfeksionim i i sistemit të ndihmës juridike falas</p> <p>Eficiencë dhe efektivitet për të garantuar akses të barabartë në drejtësi përmes shërbimeve juridike falas</p> <p>Forcimi i bashkëpunimit</p>	Patricia Pogace Xhulia Mulla	Proces në vijim
OBJEKTIVI 10: MENAXHIMI DHE PLANIFIKIMI FINANCIAR I SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE					
Nr.	Masat / proceset e planifikuar a	Aktivitetet dhe detyrat konkrete	Treguesi i suksesit/ Qëllimi	Institucioni/Dr. Përgjegjës (Personat përgjegjës)	Afate / komente

³⁷ Sipas përcaktimeve të Ligjit nr.111/2017.

10.1	<i>Vlerësimi i kostove dhe planifikimi i shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike</i>	Ndjekja, analizimi dhe planifikimi i shpenzimeve financiare mbi sistemiin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.	Mirëfunksionim i i sistemit të ndihmës juridike falas	Daniela Ndrejaj	Proces në vijim
10.2	<i>Menaxhimi i fondeve buxhetore për dhënien e ndihmës juridike</i>	Menaaxhimi i fondeve buxhetore të DNJF dhe hartimi i raportimeve financiare	Mirëfunksionim i i sistemit të ndihmës juridike falas	Daniela Ndrejaj	Proces në vijim